



**Klan Kosova**  
**Baton HAXHIU**  
**Drejtor**  
**Prishtinë**

**Ankesa Nr. 2019/71 KPM vs Klan Kosova**  
**Ref:19110/1230/KPM/mf**

### VENDIM

**Lidhur me Ankesën nr. 2019/71– Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) kundër Klan Kosova (“Palë Përgjegjëse”)**

---

#### Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) është përgjegjës për zbatimin e Kreut VIII të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës Nr. 03/L-073, përmes të cilit përcaktohet sjellja e ofruesve të shërbimeve mediale audiovizuale gjatë fushatës zgjedhore. Duke u bazuar në kapitullin e VIII të këtij Ligji, KPM ka nxjerrë udhëzuesin për të ndihmuar të licencuarit që të veprojnë në pajtim me Ligjin për Zgjedhje dhe Kodin e Etikës KKPM 2016/03 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës si dhe Rregulloren për Komunikimet Komerciale audiovizuale KPM 2017/07.
2. Me datë 19 shtator KPM i ka dërguar Palës Përgjegjëse Udhëzuesin për zbatimin e Kreut VIII të Ligjit për Zgjedhjet Nr. 03/L-073. Qëllimi i dërgimit të udhëzuesit ka qenë që të licencuarve t’ju ofrohen udhëzime për respektimin e dispozitave ligjore gjatë mbulimit të fushatës zgjedhore.
3. KPM bazuar në raportin e monitorimit të datës 19 shtator 2019, ka gjetur se Pala Përgjegjëse gjatë trasnmetimit të emisionit ”Zona Zgjedhore” ka pas sponsorizim, vendosje të produkteve si dhe reklamim me ekran të ndarë, duke vepruar në kundërshtim me Rregulloren për Komunikimet Komerciale audiovizuale KPM 2017/07.
4. KPM, pas të gjeturave nga monitorimi me datën 24 shtator 2019 i ka dërguar Palës Përgjegjëse Njoftim për shkelje, me të cilin e ka njoftuar për shkeljet e bëra dhe i ka kërkuar të veprojë në Rregulloren për Komunikimet Komerciale audiovizuale 2017/07. Poashtu, i ka ofruar mundësinë që brenda afatit prej tre (3) ditësh, pas pranimit të shkresës, të përgjigjet dhe të ofrojë sqarim në raport me shkeljet e gjetura.

5. KPM, me datën 26 shtator 2019 ka pranuar një përgjigje nga Pala Përgjegjëse duke u arsyetuar se po kalojnë në faza të vështira financiare dhe se largimi i sponsorizimit të emisioneve dhe vendosjes së produkteve do ta dëmtonë rëndë pasi që Pala Përgjegjëse është një televizion privat dhe së të hyrat janë të vogla.
6. KPM me qëllim të vlerësimit të pajtueshmërisë së Palës Përgjegjëse prej datës 25 shtator deri me 6 tetor 2019, ka bërë monitorimin e këtij subjekti dhe bazuar në raportin e monitorimit të datës 9 tetor 2019, ka gjetur se Pala Përgjegjëse ka transmetuar spot reklamues politik në të cilin ishin të përfshirë fëmijët, duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 9 paragrafi 7 i Kodit të Etikës KKPM-2016/03.
7. KPM, bazuar në raportin e monitorimit, të datës 9 tetor 2019, gjatë monitorimit të fushatës zgjedhore ka gjetur se Pala Përgjegjëse gjatë emisionit "Magazina Zgjedhore" ka pasur vendosje të produktit dhe në emisionin "Zona Zgjedhore" përveç vendosjes së produkteve, ky emision ka qenë i sponsorizuar si dhe është transmetuar reklamim me ekran të ndarë, duke vepruar në kundërshtim me nenin 12, paragrafi 1, neni 14, paragrafi 3, dhe neni 15 të Rregullores për Komunikimet Komerciale audiovizuale KPM 2017/07.

### Analiza Ligjore

8. Komisioni bazuar në të gjitha faktet dhe analizat e lartpërmendura konstaton se Pala Përgjegjëse, ka bërë shkelje 9 paragrafi 7 i Kodit të Etikës KKPM-2016/03, neni 12, paragrafi 1, neni 14, paragrafi 3 dhe neni 15, paragrafi 1 i Rregullores për Komunikime Komerciale KPM2017/07.

Neni 9, paragrafi 7, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03, përcakton se:

*"Nuk lejohet përdorimi dhe prezenca e fëmijëve në spotet e ndryshme promovuese të partive politike."*

9. Bazuar në raport të monitorimit KPM ka konstatuar se Pala Përgjegjëse ka transmetuar spot reklamues politik në të cilin spot ishin të përfshirë fëmijët, duke bërë kështu shkelje të nenit 9, paragrafi 7, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.

Nenin 12 paragrafi 1 i Rregullores për Komunikimet Komerciale KPM 2017/07 përcakton se:

*"Reklamimi me ekran të ndarë nuk duhet të jetë i tepërt në atë mënyrë që do t'ua pamundësonte shikuesve të vazhdojnë të shikojnë përmbajtjen editoriale dhe nuk duhet të përdoret në programet e fëmijëve, të fesë, të lajmeve dhe ato të çështjeve aktuale. Dispozitat e kësaj Rregulloreje në lidhje me orarin dhe kohëzgjatjen e reklamimit televiziv dhe teleshopingut do të zbatohen për reklamimin me ekran të ndarë."*

Nenin 14 paragrafi 3 i Rregullores për Komunikimet Komerciale KPM 2017/07 përcakton se:

